



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 443/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Laziq , dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës- Valon Ramadani nga subjektit politik NISMA PER KOSOVEN , dega në Ferizaj, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datën 26.06.2014 për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të datës 08.06.2014, në seancën e panelit të mbajtur me 30. 06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës –Valon Ramadani nga subjekti politik NISMA PER KOSOVEN, dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës- Valon Ramadani të subjektit politik Nisma Për Kosovën me nr.55 në Ferizaj, me të cilën pretendohet se gjatë numërimit kanë konstatuar se ka fituar vota, por votat e fituara nuk ju kanë shënuar fare në FRK. Pretenduesi i ankesës thekson se ky gabim ka ndodhë në QV.2516D/02D, dhe kërkon që ky gabim të përmissohet që sipas tij figuron edhe në rezultatin final të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka ofruar deklaratën e vëzhguesit të VV 2516D/02D- dhe kopjen e FRK-së.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “*Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme*”

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati për deputet- Valon Ramadani me nr. 55 të subjektit politik Nisma Për Kosovën në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të materialit zgjedhor në QNR, për votat e munguara të kandidatit në fjalë për të cilën pretendohet në ankesën e tij se i mungojnë votat e fituara në vendvotimin 2516D/02D.

Nga ekipi hetues i PZAP-it është hapur kutia e votimit me numër 2516/02D për Komunën e Ferizajt e cila kuti ka qenë e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shirit në mes të kutisë. Shiritat anësor të sigurisë kanë numrin 092455, 092454, 092456 dhe 092453, ndërsa shiriti i mesëm me numër 005609 nuk është prekur fare. Shiriti i thesit brenda kutisë së votimit kishte numrin 135776. Po ashtu konstatohet mbyllja e thesit brenda kutisë me shirit të sigurisë me numër 0010608 dhe mbyllja kutisë së votimit me shiritat të sigurisë me numra 034343, 034346, 034345 dhe 011460, ndërsa shiriti i mesëm nuk është prekur fare prandaj edhe ka mbetur i njëjti.

PZAP-it ka konstatuar nga origjinali i Formularit të Përputhjes së Rezultateve (FRK), që gjendet në QNR, se kandidati me nr. 55 nga radhët e subjektit politik NISMA, i posedon 2 vota e jo siç ka pretenduar në ankesën e tij se nuk e posedon asnjë votë apo nuk janë shënuar këto vota në FRK.

Për më tepër ekipi hetues i PZAP-it, e ka hapur kutin e votimit 2516D/02D, dhe i ka numëruar të gjitha fletëvotimet e kandidatit në fjalë dhe pas numërimit të votave rezultojnë se i njëjti posedon 2 vota siç edhe kanë qenë në FRK origjinal në QNR dhe poashtu të njëjtat vota janë të përfshira në rezultatin përfundimtar për kandidatin nr.55 nga radhët e subjektit politik NISMA.

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

Anr. 443/2014 më datën 30. 06. 2014



Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha

Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*